

VENDIM
Nr.428, datë 17.6.1996

PËR PERSPEKTIVËN E ZHVILLIMIT TË HEKURUDHAVE SHQIPTARE

Me propozimin e Ministrisë së Industrisë, Transportit dhe Tregtisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të miratojë skenarin e zhvillimit të ardhshëm të hekurudhave shqiptare, të mbështetur nga rekomandimet e studimit të kryer nga Instituti Irlandez CIE-Consult, me fonde të projektit të parë të transportit të financuar nga Banka Botërore, si më poshtë:

a) Veprimtaria e transportit të mallrave të shtrihet në të gjithë rrjetin hekurudhor.

b) Veprimtaria e transportit të udhëtarëve të vazhdojë në të gjithë rrjetin, me përjashtim të rasteve kur studimet ekonomike e financiare rezultojnë me humbje më të madhe sesa ajo e parashikuar në programin ekonomik të vitit në fjalë për këtë veprimtari.

2. Treguesit ekonomikë, financiarë dhe investimet deri në vitin 2005, sipas studimit, janë parashikuar në tabelën bashkëngjitur këtij vendimi. Treguesit e çdo viti miratohen me një marrëveshje që lidhet për një periudhë jo më pak se dyvjeçare ndërmjet Këshillit të Ministrave ose organit të autorizuar prej tij dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Hekurudhave.

3. Për zhvillimin perspektiv të hekurudhave të konsiderohet prioritare zgjerimi i rrjetit hekurudhor në korridorin perëndim-lindje sipas studimeve të kryera për këtë qëllim.

4. Ministria e Industrisë, Transportit dhe Tregtisë të studiojë dhe të përcaktojë mënyrën e formën e privatizimit në proceset e operimit nëpërmjet mbështetjes së konsulencës së huaj dhe të paraqesë projektligjin përkatës në Këshillin e Ministrave.

5. Në përputhje me studimin, Drejtoria e Përgjithshme e Hekurudhave të marrë masa për përmirësimin e sistemit të drejtimit dhe të organizimit, për ngritjen e zhvillimin e sektorëve të biznesit, për ndarjen e sektorit të infrastrukturës nga shfytëzimi i mjeteve të transportit, për hartimin e legjislacionit të ri për t'iu përshtatur kërkesave të ekonomisë së tregut dhe rekomandimeve e standardeve ndërkombëtare.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

DISA NGA TREGUESIT ME KRYESORE TE ZHVILLIMIT TE TRANSPORTIT HEKURUDHOR

PER PERIUDHEN 1996 - 2005

Emertimi	Njesia	1996	1997	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005
Vellimet e punes											
Trans. i udhetareve	mln ukm	218.4	234.9	247.5	261.8	284.2	285.4	286.5	287.7	288.8	290
Trans. i mallrave	mln tkm	56.6	60.5	64.8	69.3	74.3	78	81.8	85.9	90.2	94.6
Fuqia punetore	punonjes	4800	3500	3000	2700	2500	2440	2380	2320	2260	2200
Te ardhurat	mil. leke	526.2	552.5	590.1	614.3	625.4	636.5	647.5	659.5	683	706.5
Shpenzimet	mil. leke	934.7	794.7	752.6	729.6	725.9	730.2	733.3	741	761.3	782
Raporti te ardh/shp	%	56.3	69.5	78.4	84.1	86.1	87.2	88.3	89	89.7	90.3
Subvencioni	mil. leke	408.5	242.2	162.5	115.3	100.5	93.7	85.8	81.5	78.3	75.5
Investimet	mil. leke	345	364	364	340	325	325	180	180	180	180
Subvenc+invest.	mil. leke	753.5	606.2	526.5	455.3	425.5	418.7	265.8	261.5	258.3	255.5

Shenim: Treguesit e mesiperem jane llogaritur duke u bazuar ne nivelin e tarifave dhe cmimeve te vitit 1995